



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Ministrja e Ministrisë së Drejtësisë,

Në mbështetje të Ligjit 04/L-017 për Ndhimë Juridike Falas (Gazeta Zyrtare nr. 3/2012, 22.02.2012) dhe nenit 19 dhe të Ligjit nr. 08/L- 063 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Kanë të Bëjnë ne Racionalizimin dhe Vendosjen e Vijave Llogaridhëse të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare nr. 30/2022, 05.09.2022), duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 8 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.4) të Rregullores (QRK)-NR. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) - Nr. 04/2021 dhe Rregulloren (QRK) Nr. 03/2022, si dhe në pajtim me nenin 38, paragrafi 6 të Rregullores Nr. 09/2011 së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare nr. 15, 12.09.2019).

Nxjerrë:

RREGULLORE MD - NR. 05/2023¹
PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR OFRIMIN E NDIHMËS JURDIKE
FALAS NGA ORGANIZATAT JO QEVERTARE NË PARTNERITET ME
AGJENCINË PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i kriterëve për ofrimin e shërbimeve juridike falas nga Organizatat Jo - qeveritare në partneritet me Agjencinë për Ndhimë Juridike Falas (në tekstin e mëtejshëm: Agjencia).

¹ Rregullore MD-Nr. 05/2023 për Përcaktimin e kriterëve për ofrimin e ndihmës juridike falas nga organizatat Jo Qeveritare në partneritet me agjencinë organizative për ndihmë juridike falas, i nënshkruar nga Ministrja e Drejtësisë, më datë 06.06.2023.

Neni 2
Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen për Agjencinë dhe Organizatat Jo - qeveritare të cilat ofrojnë ndihmë juridike falas përmes partneritetit me Agjencinë (në tekstin e mëtejshëm: OJQ).

KAPITULLI II
KRITERET PËR OFRIMIN NE NDIHMËS JURIDIKE FALAS NGA OJQ NË
PARTNERITET ME AGJENCINË

Neni 3
Kriteret e përgjithshme

1. OJQ - ja që ofron shërbime të ndihmës juridike falas në partneritet, duhet t'i plotësojë këto kritere të përgjithshme:

- 1.1. të jetë OJQ e regjistruar në Republikën e Kosovës;
- 1.2. të jetë OJQ me veprimtari të përqendruar në njërin nga këto fusha si:
 - 1.2.1. ndihmën juridike falas;
 - 1.2.2. të drejtat e njeriut, dhe
 - 1.2.3. fushën e drejtësisë.
- 1.3. të ketë strukturë organizative të përcaktuar me aktet e brendshme të organizatës.

Neni 4
Kriteret e veçanta

1. OJQ-ja që parashtron kërkesë për hyrje në partneritet me Agjencinë për të ofruar ndihmë juridike falas, duhet të plotësojë kriteret e veçanta:

- 1.1. të parasheh në Statutin e saj se do të ofrojë shërbime të ndihmës juridike falas;
- 1.2. të ketë në kuadër të saj një anëtar të personelit me provim të dhënë të jurisprudencës;
- 1.3. të mos jetë në procedurë të falimentimit apo shuarjes;
- 1.4. që OJQ - ja të mos ketë aktakuzë të konfirmuar;
- 1.5. të mos ketë obligime të pa paguara tatimore ndaj Administratës Tatimore të Kosovës apo ka marrëveshje për shlyerje të borxheve;

1.6. emri, logoja dhe tiparet tjera identifikuese të OJQ - së të mos kenë ngjashmëri me ato të Agjencisë;

1.7. të posedojë hapësirë në zyrë të përshtatshme sipas vendosjes, hapësirës, pajisjes dhe rregullimit, e cila duhet të ketë hapësirën e përgjithshme së paku 20 m² dhe të përmbajë së paku dhomën e pritjes dhe dhomën e punës.

KAPITULLI III HYRJA NË PARTNERITET

Neni 5 Marrëveshja për Partneritet

1. Agjencia hyn në partneritet me OJQ-të të cilat ofrojnë ndihmë juridike falas në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

2. OJQ-ja që dëshiron të ofrojë shërbime të ndihmës juridike falas, duhet të lidh marrëveshje për partneritet me Agjencinë, sipas kriterëve të përcaktuara më këtë Rregullore.

3. Marrëveshja për partneritet lidhet në formë të shkruar për periudhë kohore të përcaktuar në marrëveshjen për partneritet.

4. Marrëveshja për partneritet përcakton:

4.1. shërbimet e ndihmës juridike falas që do të ofrohen nga OJQ - ja;

4.2. kategoritë e subjekteve përfituese të ndihmës juridike falas që do të ofrohen nga OJQ-ja, dhe

4.3. çështje tjera në zbatim të marrëveshjes për partneritet.

5. Marrëveshja për partneritet me OJQ-në përmban:

5.1. emrin e OJQ-së sipas emërimit në regjistrin e Organizatave Jo qeveritare në Ministrinë përkatëse;

5.2. kohëzgjatjen për ofrimin e ndihmës juridike falas;

5.3. shërbimet e ndihmës juridike falas që do të ofrohen nga OJQ-ja;

5.4. kategoritë e subjekteve përfituese të shërbimeve të ndihmës juridike falas që do të ofrohen nga OJQ-ja;

5.5. territorin në të cilin do të ofrohen shërbimet e ndihmës juridike falas.

6. Kërkesa për vazhdimin e marrëveshjes për partneritet dorëzohet në Agjenci jo më vonë se gjashtë (6) muaj para se të skadojë afati në marrëveshjen paraprake për hyrje në partneritet.

Neni 6

Kërkesa për hyrje në partneritet për ofrim të ndihmës juridike falas

1. Kërkesa për hyrje në partneritet parashtrohet në Agjenci sipas formës së paraparë në *Shtojcën I* të kësaj Rregulloreje së bashku me dokumentacionin përkatës.

2. Agjencia vendos lidhur me kërkesën për hyrje në partneritet për ofrim të ndihmës juridike falas në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i kërkesës.

Neni 7

Regjistri i OJQ-ve ofruese të ndihmës juridike falas

1. Agjencia e krijon regjistrin për OJQ-të ofruese të ndihmës juridike falas dhe e përditëson atë sipas nevojës.

2. Regjistri i OJQ-ve publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë.

Neni 8

Shkëmbimi i të dhënave

1. Agjencia dhe OJQ - të shkëmbejnë të dhëna e përgjithshme statistikore lidhur me përfituesit dhe shërbimet e ndihmës juridike falas.

2. Agjencia i ofron OJQ - së në partneritet qasje në të dhënat relevante sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe sipas kërkesës së OJQ - së.

3. Të dhënat statistikore të OJQ-së përfshihen në bazën e të dhënave të Agjencisë, sipas qasjes së lejuar në përputhje me Ligjin për Mbrotjtjen e të Dhënave Personale.

Neni 9

Përfundimi i partneritetit për ofrimin e shërbimeve juridike falas

1. Partneriteti për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas përfundon në këto raste:

1.1. kur OJQ - ja shuhet;

1.2. kalon afati i përcaktuar në marrëveshjen për partneritet dhe OJQ - ja nuk parashtron kërkesë për vazhdim të marrëveshjes;

1.3. kur OJQ - ja nuk i përmbahet kushteve për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike

falas, të përcaktuara me këtë rregullore;

1.4. për shkaqe tjera të përcaktuara me legjislacionin përkatës në fuqi.

KAPITULLI IV DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 10 Shtojcat

1. Pjesë e kësaj rregulloreje janë shtojcat si në vijim:

1.1. Shtojca 1: Kërkesa për hyrje në partneritet me Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas për ofrimin e ndihmës juridike falas;

1.2. Shtojca 2: Lista e dokumenteve.

Neni 11 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albulena Haxhiu

Ministre e Drejtësisë

___/___/2023

Shtojca 1: Kërkesë për hyrje në partneritet me Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas për ofrimin e ndihmës juridike falas

Kërkesë për hyrje në partneritet me Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas për ofrimin e ndihmës juridike falas

Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit ligjor të shoqatës/organizatës: _____

Emri i regjistruar i organizatës: _____

Veprimtaria e shoqatës/organizatës dhe hollësitë e regjistrimit të saj: _____

Data e regjistrimit: _____

Prezantimi në publik i emrit të organizatës/njesisë që do të ofrojë shërbime juridike falas dhe i logos

Ju lutemi, bashkëngjitni një kopje të logos.

Detajet e kontaktit.

Email-i: _____

Email-i alternativ: _____

Tel.: _____

Tel. alternativ: _____

Adresa e rrugës: _____

Qyteti: _____

Statusi aktual i OJQ-së: _____

A jeni të regjistruar? Po Jo

A keni obligime tatimore ndaj Administratës Tatimore të Kosovës apo ka marrëveshje për shlyerje të borxheve? Po Jo

A ka shoqata/organizata aktakuzë të konfirmuar ? Po Jo

A keni bërë kërkesë apo a jeni autorizuar që të ofroni ndihmë juridike më parë? Po Jo

Nëse po, shkruani datën e marrëveshjes për partneritet dhe bashkëngjitni vendimet paraprake ose njoftimet e refuzimit për hyrje në partneritet. _____

Për cilat lloje të shërbimeve juridike jeni duke bërë kërkesë që të hyni në partneritet për ofrim të ndihmës juridike falas?

- informatat dhe këshillat juridike lidhur me procedurat ligjore;
- përpilimin e shkresave dhe tërë asistencën tjetër teknike, që ka të bëjë me kompletimin e lëndës;
- përfaqësimin në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse.

Përcaktoni territorin/komunat në të cilat do të ofroni ndihmë juridike falas: _____

Sistemet e ofrimit të shërbimit

A keni zyrë të përshtatshme për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas? Po Jo

A keni personel me provim të jurisprudencës? Po Jo

Sa është numri i personelit në zyrën tuaj për ndihmë juridike? _____

Shkruani numrin e personelit të shoqatës/organizatës, për aq sa është e aplikueshme:

Administrator _____

Menaxher i zyrës _____

Avokat _____

Student i juridikut _____

Jurist me provim të jurisprudencës _____

Drejtor/menaxher i projektit _____

Për ata punonjës të cilët do të ndërveprojnë me publikun për të ofruar ndihmë juridike falas, ju lutemi ofroni CV-të ku paraqitet në hollësi përvoja e punës.

Numri i rasteve që janë trajtuar nga ofruesi i ndihmës juridike në deri në momentin e parashtrimit të kërkesës, për aq sa është e aplikueshme.

Deklarata

1. Informatat të cilat i kam ofruar në këtë kërkesë janë të sakta dhe të plota.
2. Pajtohem t'i pranoj të gjitha njoftimet, dokumentet dhe korrespondencën nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas.
3. Pajtohem që këto informata të përdoren për të vlerësuar kërkesën për hyrje në partneritet me organizatat jo-qeveritare për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas për të cilat kam bërë kërkesë dhe për qëllime të shqyrtimit të këtij aplikacioni sipas Rregullores MD. Nr.05/2023 për përcaktimin e kriterëve për ofrimin e ndihmës juridike falas nga Organizatat Jo-Qeveritare.
4. E kuptoj që për qëllime të shqyrtimit të kësaj kërkesë mund të kërkohen edhe informata të tjera.
5. E kuptoj që duhet t'i shpalos sa më shpejtë që të jetë e mundur, informatat lidhur me çfarëdo çështje që mund të ndikojë kualifikueshmërisë time të vazhdueshme për t'u autorizuar si ofrues i shërbimeve për ndihmë juridike falas.

Emri dhe mbiemri: _____

Nënshkrimi: _____

Data: _____

Këshilla juridike

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas do të konfirmojë pranimin e kërkesës. Ju nuk mund të konsideroheni se ofroni ndihmë juridike në partneritet me Agjencinë deri sa të miratohet kërkesa.

Nëse aplikacioni juaj nuk është i plotë ose nuk është në formatin e duhur duke përfshirë dokumentet e bashkëngjitura, Agjencia do t'ju kërkojë plotësim të dokumentacionit për shqyrtim të mëtejshëm.

Shtojca 2: Lista e dokumenteve

Lista e dokumenteve

Ju lutemi të vendosni një (✓) në katrore nëse janë bashkëlidhur dokumentet e kërkuara.

Dokumenti

Letërnjoftimin e përfaqësuesit ligjor	
Certifikata e regjistrimit të OJQ-së	
Statuti i OJQ-së	
Dokumentacionin relevant tatimor	
Dëshminë që organizata nuk ka aktakuzë të konfirmuar	
Logon e organizatës apo njësisë që do të ofrojë shërbimet e ndihmës juridike falas	
Kopjet e të gjitha certifikatave të diplomimit universitar dhe dokumentet e licencës juridike për atë që është e aplikueshme për personelin përkatës.	
CV-të e të gjithë personelit që do të ndërveprojë me kërkuesit e ndihmës juridike falas.	
Vendimet për partneritetin paraprak	
Organogrami	

Nëse keni bashkëlidhur dokument tjetër, ju lutem shënoni cilin.
